

BULETIN VJETOR

RRJETI KOMBËTAR I ORGANIZATAVE
ROME/EGJYPTIANE

“SË BASHKU PËR FORCIMIN E ZËRIT
ROM/GJYPTIAN NË SHQIPËRI”



Punoi dhe Redaktoi:

Anjeza KOLAMI

Kordinatore Projekti

Unioni Amar-Drom

Ky material është financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe We Effect.

Sida dhe We Effect jo domosdoshmërisht bien dakort me mendimin e shprehur. Vetëm Autori është përgjegjes për përmbajtjen.

©Unioni per Zhvillimin dhe Integrimin te Minoritetit Rom ne Shqiperi "Amaro-Drom"

Adresa: Rr. Sulejman Pasha, Lagjia.4, P.2, Shk.3. Tiranë, Shqipëri

Telefon/Fax: 00355 4 248925 & 231391

E-mail: amarodrom@abissnet.al

Website: www.unioniamarodrom.com

PËRMBAJTJA

1. RRETH PROJEKTIT



5

1.1 MBËSHTETJA DHE KONTRIBUTI I PROJEKTIT PËR VITIN 2016

Projekti financohet nga We Effect dhe është i fokusuar
në tre komponentë kryesorë:

a. Ngritje kapaciteti;	6
b. Zhvillim biznesi;	7
c. Lobim dhe advokim.	8-9

2.

RRJETI KOMBËTAR I
ORGANIZATAVE ROME
DHE EGJYPTIANE

2.1
MISIONI

2.2
QËLLIMI

10

3. AKTIVITETET



11-32

3.1 Takimet e në kuadër në kudër të Rrjetit të organizatave Rome dhe Egjyptiane	11
3.2 Workshop ndërgjegjësues “Të drejtat e Minoritetit Rom dhe Egjyptian në regjistrimin civil”	16
3.3 Workshop ndërgjegjësues “E drejta e minoritetit Rom për të përfutur statusin e minoriteteve në Shqipëri”	23
3.4 Networku Rajonal për Dekadën Rome	27

PARATHËNIE

Ky buletin është konceptuar të shërbejë si një instrument informimi i cili do të përçojë brenda dhe jashtë Shqipërisë zërin e komunitetit Rom dhe Egjyptian. Ai do të jetë në funksion të aktiviteteve të rrjetit i cili është themeluar si një iniciativë e Unionit "Ama-ro-Drom", në kuadër të projektit "Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri", financuar nga We Effect.

Ky botim periodik (vjetor) është një mjet për publikun e gjerë, për institucionet qeveritare / jo qeveritare dhe këdo që është i interesuar të njihet me përpjekjet për të identifikuar dhe zgjidhur problematikat e këtij komuniteti.

Botimi i këtij buletini është një rast i mirë për të dokumentuar aktivitetet, iniciativat lobuese dhe advokuese të shoqërisë civile Rome dhe Egjyptiane në Shqipëri.

Rrjeti Kombëtar i Organizatave Rome / Egjyptiane ka kapacitetin e duhur për të nxitur angazhimin e qeverisë në zbatimin e plotë të planeve konkrete referuar masave prioritare dhe planifikimeve specifike buxhetore.

Rritja e bashkëpunimit midis këtyre organizatave e bën edhe më të lehtë rrugën drejt integritetit të komunitetit rom

Integrimi i një shoqërie nuk mund të perceptohet pa integrimin e këtyre pakicave etnike, ndaj:

"Le ti japim fund njëherë e përgjithmonë hendekut socio-ekonomik mes popullsisë rome dhe jo rome!"

Mirënjohje dhe falenderim i vecantë shkon për të gjithë anëtarët e Rrjetit Rom dhe Egjyptian për kontributin e dhënë gjatë këtij viti.

IIIIII RRETH PROJEKTIT

Projekti "Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri" është një projekt tre vjeçar (2014-2016) i cili zbatohet në komunitetet Moravë, Grabian, Plug, Gramsh & Zhamë.

Projekti financohet nga We Effect dhe është i fokusuar në tre komponentë kryesorë:

- 1. Ngritje kapaciteti;**
- 2. Zhvillim biznesi;**
- 3. Lobim dhe advokim.**

Ndër të tjera, ky projekt synon që të kontribuojë në forcimin e zërit Rom në Shqipëri përmes Lobimit dhe Advokimit.

MBËSHTETJA DHE KONTRIBUTI I PROJEKTIT PËR VITIN 2016

NGRITJE KAPACITETI



- Gjatë vitit 2016 janë ofruar programe për ngritjen e kapaciteteve të stafit qendror dhe lokal të Amaro-Drom". Në mënyrë të veçantë kordinatorëve lokal iu ofrua këtë vit mundësia në certifikimin në modulin bazë "Në menazhimin e projekteve"
- Ofrimi i programeve fotoshop dhe design për stafin qendror të Amaro-Drom
- Zhvillimi i databases se antarsimit pranë Unionit "Amaro-Drom", në të cilin është bërë e mundur përfshija dhe hedhja e të dhënave bazë të antarëve të minoritetit Rom dhe pajisjen e tyre me kartë antarësimi (në total numri antarëve arrin shifrën 6562 antarë (nga të cilat 3198 janë femra).



Janë zhvilluar dy **Takime të Komitetit për Menaxhimin e Projekti.**

Cështjet më evidente që u trajtuan në këto takime ishin:

- Rritja e bashkëpunimit të pushtetit lokal (Bashkisë Berat, Lushnjë, dhe e Divjakës) në reduktimin e nevojave që ky komunitet paraqet tek pushteti lokal
- Koordinimi dhe bashkëpunimi midis pushtetit lokal, qendrave të formimit profesional, bizneseve dhe zyrës së punës, në krijimin e mekanizmave lehtësuese për të përfshirë gratë dhe të rinjtë rom në tregun e punësimit



ZHVILLIM BIZNESI



Shkëmbim eksperience me fermerët Rom në Grabjan-Lushnjë.

Fermerët ndanë me njëri-tjetrin eksperiencat e tyre, modelet pozitive, barrierat që mund të kishin hasur gjatë kultivimit të kulturës së grurit. Ekspertë nga Instituti i transferimit të teknologjive të reja, informuan fermerët mbi varietetet e grurit që ishin kultivuar në bazën eksperimentale, varietetet e ndryshme të grurit të kultivuar në një parcele të vetme, prodhimi që jep cdo varietet, etj..

Shkëmbim eksperience me fermerët Rom në Kosovë,

fermerët ndanë me njëri-tjetrin eksperiencat dhe modelet më të mira rreth kultivimit të kulturave të larmishme, për të prodhuar në vendin e tyre. (Fermerët në Kosovë kishin kultivuar kulturën e luleshtrydhes dhe mjedrës, gjë që ishte një risi për fermerët në Shqipëri).

Botimi i broshurës duke orjentuar fermerët romë dhe jo romë drejt mbështetjes financiare nga mikrofinancimet. Ata mund mund të zgjerojnë aktivitetin e tyre falë mbështetjes që mikrofinancimet ofrojnë.

Kryerja e studimit “Vlerësimi i tregut” Ky studim ka për qëllim informimin e fermerëve në lidhje me:

- Rëndësinë që ka vlerësimi i tregut
- Njohuri rreth konsumatorit për të kuptuar nevojat e tyre
- Mënyrat që fermerët duhet të zgjedhin për të shitur produktet e tyre në: treg shumice, pakice, pikë grumbullimi etj..

Trajnim “Mbështetja për Shoqatat e Fermerëve” Trajnues të teknologjive të reja informuan fermerët mbi rëndësinë që ka krijimi i kooperativave kapitaliste bujqësore në fuqëzimin e tyre në treg.

Mbështetja e 9 fermerëve në kulturën e grurit (në 4 zonat e targetuara të projektit).

Edukim profesional/trajnime në punë (për gratë dhe të rinjtë romë)

65 pjesmarës në total kanë marrë pjesë në kurset profesionale (2014-2016) kryesisht në: parukeri, berberi, rrobaqepsi, hidraulik, mekanik, shofer, njohuri kompjuterike, pastičeri, shofer.

AVOKIMI DHE RRJETËZIMI

- I ORGANIZUAR NE TRE NIVELE -

Avokimi dhe rrjetëzimi janë organizuar në tre nivele:

- a. në nivel LOKAL
- b. në nivel KOMBËTAR
- c. në nivel NDËRKOMBËTAR

Në nivel lokal

- Janë kryer rregullisht takimet e forumeve romë në 4 zonat e targetuara të projektit (dy takime çdo muaj në katër komunitetet)
- Iniciativat të ndërmara nga forumet (restaurim banesash, pastrim mbeturinash, vendosje të koshave për mbeturina, banesa sociale (në komunitetin e Grabjanit) etj...

Është ofruar ngritja e kapaciteteve të aktivistëve Rom nëpërmjet Workshopit

Iniciativat e ndërmara nga forumet romë, sfidat e hasura në bashkëpunim me pushtetin lokal (4 workshope në total) Me pjesëmarrjen e 80 përfaqësuesve (41 prej tyre ishin femra)



Workshop ndërgjegjësues mbi çështjet dhe barazi gjinore **"Përfshirja Sociale e gruas Rome për të mbrojtur të drejtat e saj"** (4-workshope në total). Disa nga çështjet më evidente që u trajtuan në workshop ishin: Si të arrijmë përfshirjen sociale, cilat janë disa nga të drejtat prioritare të gruas, si ti mbrojnë këto të drejta, etj... Në total morën pjesë 86 pjesëmarrës (48 prej tyre ishin femra).



Organizimi i panarit në nivel lokal (Në qytetin e Lushnjës). **Qëllimi i këtij panairi i shtë promovimi i vlerave, kulturës dhe traditës romë si dhe nxitja e prodhimeve agrikuturore vendase.**

Ky aktivitet u mbyll me moton : "kultura nuk njihet ngjyrim dhe karakteristika të vecanta por shkrihet dhe bashkohet në një vlerë të përbashkët universale për të pasuruar diversitetin, të vecantën, uniken, në një vlerë të vetme: të gjithë jemi të ndryshëm por të barabartë".

Në nivel Kombëtar

Workshop ndërgjegjësues organizuar nga Rrjeti Kombëtar **"E drejta e regjistrimit civil për komunitetin Rom dhe Egjiptian në Shqipëri"**.

Workshop ndërgjegjësues organizuar nga Rrjeti Kombëtar **"E drejta e minoritetit rom për të përfituar statusin e minoriteteve në Shqipëri"**

Në nivel Ndërkombëtar

Eventi ndërkombëtar u organizua në Tiranë nga Amaro-Drom në kuadër të projektit "Përmirësim i Qëndrueshëm i Jetesës së Komuniteteve Rome në Shqipëri" financuar nga We Effect.

Me qëllim Integrimin e Romeve dhe Rritjen e Bashkëpunimit midis Shteteve në Rajon.

Rrjeti kombëtar i organizatave Rome/Egjyptiane

Rrjeti Kombëtar i Organizatave Rome, “Së bashku për forcimin e zërit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri”, u krijua në 18 Qershor të vitit 2014 si një iniciativë e Unionit për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në shqipëri Amaro-Drom.

Këtij rrjeti deri tani i janë bashkangjitur 13 organizata Rome dhe Egjyptiane dhe 18 aktivistë të cilët synojnë ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta në dobi të forcimit dhe zhvillimit të këtyre komuniteteve. Rrjeti mbetet i hapur për të mirëpritur organizata apo shoqata të tjera të cilat shprehin interesin për të qënë pjesë e këtij misioni.

2.1 QËLLIMI

Forcimi i zërit Rom/Egjyptian në nivel kombëtar, duke lobuar, advokuar, shkëmbyer eksperiencat dhe praktikatat më të mira për çështjen Rome/Egjyptiane.

2.2 MISIONI

- Të advokojë dhe llobojë në emër të komunitetit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri.
- Të ndërgjegjësojë institucionet shtetërore dhe shoqërinë për të njohur dhe respektuar Romët dhe Egjyptianët.
- Të nxisë pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve Rom dhe Egjyptian.
- Të koordinojë dhe promovojë eksperiencat më të mira në mbrojtjen e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri.

3.1 TAKIMET E RRJETIT

Më datë 30. 03.2016 u zhvillua takimi i radhës me Rrjetin Kombëtar Rom, me përfaqësues të organizatave Rome/Egjyptiane, përfaqësues nga administrata, dhe aktivistë të cilët punojnë për përmirësimin e jetës të komunitetit Rom. Workshopi u organizua në Tiranë nga Rrjeti Kombëtar “Së bashku për forcimin e Zërit Rome/Egjyptian në Shqipëri” udhëhequr nga Unioni Amaro-Drom në kuadër të projektit “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri” financuar nga We Effect.

Ky takim mbledhi së bashku pjesëmarrës të ndryshëm të cilët përfaqësonin qeverisjen lokale dhe qendrore (Bashkia e Tiranës dhe Ministrinë e pushtetit vendor); organizata të shoqërisë civile Rome/Egjyptiane të cilat veprojnë në Shqipëri.

Takimi nisi me regjistrimin e pjesëmarrësve, ku morën pjesë përfaqësues të organizatave nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Së bashku me stafin e "Amaro – Drom" numri total i pjesëmarrësve ishte 30 persona, mes tyre 16 femra dhe 14 meshkuj.

Pas fjalës përshëndetëse të **Z.Skënder Veliu**, Drejtori Ekzekutiv i "Unioni për zhvillim dhe Integrim të Minoritetit Rom "Amaro – Drom" falenderoi të pranishmit për prezencën e tyre, dhe shpjegoi **qëllimin e takimit që lidhej me Reformën Teritoriale, rëndësinë që ka kjo reformë në ofrimin e shërbimeve për komunitetin Rom dhe Egjiptian.**

Pas prezantimit të Z.Veliu, fjalën e mori **Znj. Vasilika Trimi** specialiste pranë ministrisë vendore. Fillimisht Znj.Trimi prezantoi Strategjinë e Reformës teritoriale, misionin që ajo ka në vetvete, dhe politikat që do të ndiqen për të mundur ndryshime të prekshme dhe produktive në të njëjtën kohë.

Sipas Znj. Vasilika, agjensia për ndarjen teritoriale, lindi si një domosdoshmëri sepse 80% e ish komunave ishin jo eficiente dhe jo efektive për dy arsye kryesore:

së pari: Sepse përfshinin një numër të madh punonjësish

së dyti: Ishte një buxhet shumë i madh që nuk justifikonte ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare, për këtë arsye lindi si një domosdoshmëri një reformë e re për të mundur ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare.

Këto institucione (ish -Komunat) kishin në përbërjen e tyre një departament me një numër të lartë punonjësish, të cilët ishin vënë në dispozicion për të ofruar shërbime përkundrejt komunitetit që i përkiste asaj zone, por kjo politikë ishte tërësisht e dështuar, vijoi Znj. Trimi sepse buxheti i Shtetit vendoste në dispozicion një buxhet relativisht të lartë për të punësuar një numër të lartë punonjësish në këto njësi administrative, ndërkohë që u pa e arsyeshme që ky buxhet mund të menaxhohej në një formë të re, kjo politikë e re e reformës teritoriale nënkupton reduktimin e numrit të punonjësve, dhe rritjen e investimeve për të rritur mundësinë e përfitimeve të komunitetit përkundrejt shërbimeve me bazë komunitare, por jo vetëm.

Kjo strategji pati në fokusin e saj edhe përfshirjen e specialistëve për të rritur në këtë mënyrë cilësinë e shërbimit.

Aktualisht mund të themi se Reforma Teritoriale ndodhet në fazën e përcaktimit të teritoreve.

Janë ndërtuar struktura të reja që kanë një drejtor me të cilën koordinonjë me pushtetin vendor.

Këto njësi, pra zyrat me një ndalesë, shërbejnë jo vetëm për të ofruar shërbime, por edhe për të mundur mbledhje online për të mundur në këtë mënyrë mbledhje me njësitë administrative.



Si përfundm Znj. Trimi theksoi se kjo reformë nuk ka në politikën e saj largimin e shërbimeve nga qytetari, aktualisht janë duke u ndërtuar 29 plane strategjike për mënyrën se si do të operohet me ofrimin e shërbimeve.

Është rritur përgjegjsia e njësive bashkiake, ku një nga prioritetet që ky institucion do të ketë në vëmendje, do të jenë çështjet sociale të shërbimeve me bazë komunitare.



Fjoralba Haxhi, një tjetër specialiste e ftuar nga bashkia e Tiranës, midis të tjerash u ndal gjërësisht tek riorganizimi i shërbimeve, dhe mënyrës se si këto shërbime do ti vijnë në ndihmë komunitetit në tërësi, dhe konkretisht komunitetit Rom dhe Egjyptian.

Znj. Fjoralba e konsideroi si tepër të rëndësishme mënyrën se si ky institucion kordinon me komunitetin, dhe se sy ky komunitet mund ti drejtohet për të ndërmarrë shërbimin e duhur, pavarësisht se nuk ka një departament të vecantë që ti vijë në dispozicion vetëm komunitetit Rom dhe Egjyptian,

Nga ana tjetër ajo informoi të pranishmit, se brenda njësive bashkiake është zyra e përkatësisë gjinore, ku në këtë zyrë cdo qytetar gëzon aksesin për të paraqitur nevojat që ai mund të ketë.

Bashkia operon nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve specifike veprimi, duke hartuar në këtë mënyrë projekte të detajuara për ti ardhur në shërbim një komuniteti të caktuar.

Kjo politikë është ndjekur dhe është vënë në zbatim edhe për komunitetin Rom/Egjyptjan, sic mund të përmendim projektin e Shkozës, projekte të tilla nuk janë gjë tjetër vecse tregues të mirfilltë për të fuqëzuar komunitetin.

Një tjetër projekt konkret që i ka ardhur në ndihmë këtij komuniteti, lidhet me komunitetin e Liqenit, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre u mbështet me pagesën e qerasë për një perjudhë të përkohshme (dy vjetecare).

Janë ndërtuar 24 njësi administrative ku 13 janë ish Komuna, dhe fokusi është Tirana, e cila ka një dimension të zgjeruar shërbimesh.

Duhet projektuar hapat për të vazhduar përpara, dhe sidomos në zonat e largëta, sepse më shumë gëzojnë aksesin përkundrejt shërbimeve komunitetet e qyteteve të mëdha.

Nuk duhet të mjaftohemi vetëm me ndihmën ekonomike, por është menduar që të shoqërohet me kapacitete profesionale (një punonjës social) i cili do të meret drejt përdrejt me trajtimin e problematikave që paraqet një antar i një komuniteti të caktuar.

Një tjetër departament që ndodhet brenda cdo njësie bashkiake është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve. Shërbimet, vijoi Znj. Haxhi duhen të kordinohen në atë mënyrë që të shkojnë drejt përdrejt tek komuniteti.

Në rastin konkret për komunitetin Rom dhe Egjyptian projekti i Shkozës është një projekt i cili ka rezultuar i sukseshëm.

Projekte të tjera të cilat do të ndërtohen në vazhdimësi, por gjithmonë në bashkëpunimin e përfaqësuesve të komunitetit për të ngritur problematikën në mënyrë që të përmbushen nevojat e tyre.

Kjo reformë lidhet me ofrimin e shërbimeve edhe për zonat e largëta, pasi egziston mundësia vetëm në qytetet e mëdha të Shqipërisë.

Bashkia funksionon me plane konkrete veprimi duke ju referuar nevojave specifike të një komuniteti, vijoi zonja Haxhi, ajo që është shumë e rëndësishme sipas saj, duhet të mbështesim dhe të tentojmë drejt shërbimeve multidimensionale.

Znj. Manjola Veizi, (Qendra për të Drejtat e Gruas Rome) u shpreh se politikat për komunitetin Rom dhe Egjyptian janë politika përjashtuese dhe aspak favorizuese, dhe automatikisht i kanë përjashtuar këto komunitete përkundrejt shërbimeve, pavarësisht nismave të ndërmara nga bashkia për të ndërhyrë qoftë në komunitetin e Selitës, dhe komunitetin e Liqenit, situata e atyre familjeve mbetet ende një çështje e pa zgjidhur, çështja e strehimit mbetet një nga probelet kryesore e këtij komuniteti, dhe politikat për të qënë pjesë përfituese e banesave sociale vazhdon të mbetet në disfavorin e këtij komuniteti, pasi kritetret e përfitimit të këtij shërbimi i përjashtojnë komunitetin Rom dhe Egjyptian. Ajo që duhet të bëjmë ne si organizata të forcojmë zërin rom.

Kordinatore e projektit Anjeza Kolami u ndal konkretisht:

- Kjo reformë lidhet me ofrimin e shërbimeve edhe për zonat e largëta, pasi egziston mundësia vetëm në qytetet e mëdhaja të Shqipërisë.
- kërkon kohën e vet për të marrë formën dhe përmbajtjen e duhur, në mënyrë që të shikojmë edhe benefitet që do ti ofrojë këtij komuniteti.
- Është shumë e rëndësishme përfshirja e antarëve të komunitetit Rom dhe Egjyptian pranë pushtetit lokal sepse njohin nevojat, dhe adresojnë problematikat e komunitetit të tyre.
- Mardhëniet e komunitetit me pushtetin lokal duhet të jenë të mundshme, duhet të rritet fryma e bashkëpunimit midis tyre.

Disa rekomandime kryesore në lidhje me tematikën kryesore të këtij takimi ishin:

- Është shumë e rëndësishme përfshirja e antarëve të komunitetit Rom dhe Egjyptian pranë pushtetit lokal, sepse njohin nevojat dhe adresojnë problematikat e komunitetit të tyre.
- Mardhëniet e komunitetit me pushtetin lokal duhet të jenë të mundshme dhe nuk duhet të ndërpriten , por të rritet fryma e bashkëpunimit midis tyre.
- Edhe në ato raste kur kemi përfaqësinë nga komuniteti në këtë institucion, nuk duhet thjesht të mendojnë për karigen por të dinë të ngrenë zërin e tyre dhe të mbrojnë interesat e komunitetit të tyre.
- Ne kemi përfaqësi edhe në pushtetin vendor, por nuk kanë dalë në vullnetin e lirë, ne i kemi mbështetur me votën tonë ndaj këta përfaqësues duhet të japin llogari dhe të marin përgjegjësitë e tyre.
- Lëvizja Rome edhe pse ka që në 2008 që është themeluar është jo funksionale, ndaj ajo që unë propozoj, lidhet me rritjen e përfaqësuesve të komunitetit rom dhe egjyptian në pushtetin lokal.
- Kemi përgatitur gjenerata të reja, juristë, ndaj ka ardhur momenti që kjo gjeneratë të na ndërtojë një program, një plan veprimi. Ajo që unë e theksoj përsëri, ka ardhur momenti që ne duhet të ngermë fuqishëm zërin për të vendosur njerzit tanë që të na përfaqësojnë në këto institucione.
- Në kuadër të projektit We -Effect na ka dhënë edhe më shumë mundësinë për tu bashkuar dhe për të fuqëzuar Zërin Rom.
- Gjetëm rrugën që jemi të gjithë së bashku, zëri rom është një nisëm që duhet zgjeruar më tej.
- Ne kemi qënë në një koherencë të vazhdueshme duke ndjekur çështjen e strehimit, dhe kemi dërguar shkresa të herpashershme Bashkisë dhe Zhvillimit Urban, cdo nismë e ndërmarë nga ne si zyrë qendrore është protokolluar dhe është e ruajtur në arkivën tonë, dhe unë do t'ju nis me email për tu njohur me situatën. Ne gjithashtu kemi marë edhe përgjigje për këtë çështje jo vetëm nga bashkia por edhe nga Zhvillimi Urban.
- Duhet të kemi specialistë kryesorë, jam gati për të hartuar priojekte propozimi për të mbështetur zërin rom nëpërmjet medias.
- Nuk ka një zgjidhje përfundimtare për situatën e familjeve të selitës, apo për familjet e shkozës, situata e strehimit mbetet një çështje që nuk ka gjetur zgjidhje, dhe politikat për të përfutur banesë sociale janë përjashtuese dhe aspak favorizuese.

- Romët nuk kanë akses për të përfituar përkundrejt shërbimeve sociale.
- Nuk kemi përfaqësi në pushtetin lokal nga komuniteti.
- Duhet të fuqëzojmë zërin dhe pjesmarrjen rome nëpër institucione. Ajo që është shumë e rëndësishme nuk duhet të humbasim mardhënien me komunitetin, sepse komuniteti di më mirë se kushdo tjetër që të përcjellin problematikat e tyre.
- Cështja e Selitës, mbetet një cështje e pa zgjidhur si shumë cështje të tjera që kanë të bëjnë me strehimin dhe mobilizimin e romëve.
- Ende si komunitet nuk kemi përfaqesit tanë në politikë.
- 8 Prilli edhe për ne nuk mund të perceptohet si një ditë festive, por si një ditë që do të përcojmë problematikat e komunitetit tonë në parlament.
- Romëve u mungon kultura politike, duhet të punojmë shumë fort për këtë cështje.
- Duhet të fuqëzohet zëri i tyre dhe pjesmarrja aktive e këtyre komunitete në institucione vendimare për të rritur adresimin e problematikave dhe nevojave të tyre por në të njëjtën kohë edhe për të përmbushur nevojat që ky komunitet paraqet.
- Nxitjen e qytetarëve për të mundësuar fuqëzimin e strukturave komunitare në zonat rurale dhe urbane, duke ndërtuar struktura komunitare që do të nxisin aktivizimin dhe pjesëmarrjen qytetare.



3.2 WORKSHOP NDËRGJEGJËSUES

“TË DREJTAT E MINORITETIT ROM DHE EGJYPTIAN NË REGJISTRIMIN CIVIL”

Në 8 Shtator 2016, 24 pjesëmarrës (11 Femra) nga qytete të ndryshme të Shqipërisë morrën pjesë në workshopin me temë “E drejta e Regjistrimit Civil për komunitetin Romë/Egjyptian në Shqipëri”. Workshopi u organizua në Tiranë nga Rrjeti kombëtar “Së bashku për forcimin e zërit Rome/Egjyptian në Shqipëri” udhëhequr nga Unioni Amaro-Drom, në kuadër të projektit “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri” financuar nga We Effect.

Pjesëmarrësit në këtë workshop ndanë mendimin se nevojitet një angazhim i fortë i sensibilizimit të komunitetit për të synuar përmirësimin e situatës së regjistrimit të fëmijëve Rom dhe Egjiptian pranë gjëndjes civile, sepse rritja e interesit të tyre mbi rëndësinë e kësaj të drejte, do të bëjë të mundur reduktimin e shumë problematikave të tjera që vijnë si rezultat i mungesës së regjistrimit civil. Shumë antarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, si rezultat të kushteve të vështira të jetesës, nuk arrijnë të krijojnë një stabilitet në një vendbanim të caktuar, ndaj për të ndryshuar këtë situatë, dhe për të përmirësuar statusin e tyre ekonomik, migrojnë dhe emigrojnë në mënyrë të vazhdueshme. Nëse migrimi dhe emigrimi është një nga faktorët që ka ndikuar në rritjen e rasteve të fëmijëve të pa regjistruar pranë zyrave të gjëndjes civile, ndikojnë dhe shumë faktorë të tjerë sic mund të përmendim: martesat në moshë të hershme, niveli i ulët arsimor, neglizhenca e prindërve, mungesa e informacionit, mungesa e dokumentacioneve bazë për regjistrimin e fëmijës, kostot e larta financiare në ato raste kur fëmija është lindur në një shtet tjetër etij..

Adresimi i një shifre konkrete në lidhje me përcaktimin e shkallës së rrezikshmerisë të këtij fenomeni është shumë e vështirë për tu mundur, sepse nuk mund të marim për bazë vetëm nr e rasteve që janë evidentuar, pasi ka shumë raste të fëmijëve që nuk janë bërë evidente.

Kur themi se nr i fëmijëve vetëm nga zyra Ligjore Falas për vitin 2015 janë regjistruar 5015 fëmijë, nga te cilat 60% e tyre i përkisnin fëmijëve të komunitetit rom dhe Egjiptian, nuk mund të pretendojmë se kemi përcaktuar shkallën e rrezikut, sepse ka shifra të tjera alarmante të evidentuara nga aktorë të tjerë, ka raste që janë në proces gjyqësor, ka dhe raste që nuk janë bërë ende evidente.

Pjesëmarrësit e këtij workshopi, patën mundësinë të njiheshin me hapat konkrete që Amaro-Drom ne bashkëpunim me TLAS kanë ndërmarrë ndër vite, në reduktimin e nr të fëmijëve të pa regjistruar, duke lobuar për të përmirësuar legjislacionin për të lehtësuar procesin e regjistrimit të fëmijëve Rom dhe Egjiptian, duke marrë në konsideratë statusin socio-ekonomik shumë të ulët.

Ata diskutuan, shpjeguan dhe përcaktuan qëllimet e tyre të përbashkëta duke ndarë edhe përvojat pozitive mbi kete ceshtje, duke bere transparente dhe pengesat qe kishin hasur dhe sfidat qe kishin kaluar gjate punes se tyre.

Workshopi mbledhi së bashku pjesëmarrës të ndryshëm të cilët përfaqësonin Zyrën ligjore Falas (TILAS), ministria e arsimit, aktiviste, organizata të shoqërisë civile Rome/ Egjiptianetë cilat veprojnë në Shqipëri.



3.2.1 QËLLIMI KRYESOR I WORKSHOPIT

Qëllimi i këtij workshopi ishte nxitja e të gjithë aktorëve kompetente dhe gjetja e mekanizmave të duhur, për të rritur aksesin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në regjistrimin civil.

Workshopi ishte i ndarë në 3-sesione:

Sesioni I - Situata e Regjistrimit civil të Romëve/Egjiptianëve dhe Kuadri ligjor, shkaqet dhe pasojat që vijnë si rezultat të mos regjistrimit të fëmijëve pranë gjendjes civile.

Sesioni II - Adresimi i rrezikut të pashtetesisë së komunitetit Rom dhe Egjiptjan në Shqipëri,

Session III - Prezantimi rasteve të ndryshme të regjistrimit civil, ndarja në grupe, nxjerja e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Në pjesën e fundit në axhendë ishte planifikuar diskutimi për një nëncështje tjetër të rëndësishme, e drejta e romëve dhe egjiptjanëve për tu arsimuar.

Moderimi u realizua nga Z. Skender Veliu, Drejtor Ekzekutiv i Unionit të Romëve të Shqipërisë Amaro-Drom.

Pas prezantimit të rendit të ditës, Z. Veliu theksoi qëllimin e këtij workshopi dhe falënderoi për pjesëmarrjen në këtë aktivitetet, përfaqësuesit e Zyrës ligjore falas Tlas, Ministrisë së arsimit organizatat e shoqërisë civile Rome/Egjiptiane, aktivistë dhe të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi.

Gjatë fjalës së tij Z. Veliu përmendi se gjatë kësaj periudhe Amaro-Drom ka qenë e përfshirë në çështjen e regjistrimit të fëmijëve në bashkëpunim me zyrën TLAS. Kjo frymë bashkëpunimi mbetet një nisëm shumë e mirë për të reduktuar nr e fëmijëve të pa regjistruar të komuniteteve Rome/Egjiptiane në Shqipëri.

3.2.2 KONTRIBUTET NGA SESIONET PLENARE

Gjatë sesionit të parë të workshopit Znj. Rajmonda Bozo, drejtoreshë e zyrës ligjore falas, prezantoi situatën e regjistrimit civil të komunitetit Rom në Shqipëri.

Për 18 vite shërbimi në këtë fushë, ajo shprehu mirënjohje sepse eksperiencën e parë me regjistrimin civil e kishte zhvilluar me Amaro-Drom, dhe ndjehej e privilegjuar që ky bashkëpunim vazhdon të mbetet ende i ngushtë dhe tepër rezultativ që nga viti 2003 dhe deri tani.

Siç ajo edhe e përmendi, situata e regjistrimit civil për pjesën më të madhe të komunitetit Rom në Shqipëri është e karakterizuar nga kushte të ngjashme:

- Fenomen që nuk na paraqet një reduktim të rasteve të evidentuara ndër vite.
- Mungesë bashkëpunimi dhe neglizhencë nga ana e prindërve të fëmijës.
- Procedura dhe kohëzgjatje në ato raste kur procesi i regjistrimit kalon në prcese gjyqësore.
- Mos koordinim i aktorëve kryesorë për të realizuar frymën e bashkëpunimit.
- Mungesë informacioni ose shtrembërim informacioni gjatë raportimit fillestar të rastit.

Z. Bozo u ndal në aspektin legjislativ të kësaj çështje, duke theksuar rëndësisë që i ka kushtuar zyra ligjore falas në përmirësim të legjislacionit për regjistrimin civil. Ajo prezantoi para të ftuarve nismën e ndërmarrë në vitin 2012 nga TILAS, në bashkëpunim me ministrinë e brendshme, për të ndërmarrë inicjativë serioze në legjislacion, ndaj u hartua udhëzimi për regjistrimin Civil.

Sipas këtij udhezuesi, në rastet e fëmijëve të rezultuar të gjetur, aktorët kryesorë që do të përfshiheshin në regjistrimin e fëmijës do të ishte kopetencë e zyrës së gjëndjes civile në kordinim dhe bashkëpunim me punonjësin social, policinë, dhe një i afërm i familjes.

Edhe pse pritshmëritë pas venies në zbatim të këtij udhezimi ishin shumë efikase, nuk rezultoi kështu sepse praktikisht ky proces vazhdon të jetë evident dhe numri i këtyre fëmijëve paraqitet me shifra alarmante. Ky udhëzim sipas zonjës Bozo, zbatohet shumë pak në praktikë.

Si shkakun kryesor se përse mbetet një proces i veshtirë ajo e lidhi me nevojën që kanë familjarët apo kujdestarët romë në regjistrimin e tyre. Nga eksperjenca e saj, Z.Bozo u shpreh se shpesh familjarët shfaqin mungesë informacioni, ose shtrembërim informacioni sepse mendonjë se mos dikush i heq të drejtën prindërore apo atë të kujdestarisë. Ndaj që të realizohet një asistim i plotë, kërkon kosto, persona që njohin kopetencat profesionale dhe ligjore.

Z.Bozo gjatë prezantimit të saj, i kushtoi një rëndësi të vecantë burimeve mbështetëse të informacionit për procesin e regjistrimit të një fëmije pranë gjëndjes civile.

Ajo theksoi se bashkimi i burimeve të informacionit kryesisht nga: shërbimi shëndetësor, cerdhja, kopshti, shkolla, komuniteti, policia) etj.. është shumë e rëndësishme kur ky informacion paraqitet në kohë pranë zyrës së gjëndjes civile, sepse sa më gjatë të shkojë mos regjistrimi i fëmijës, rritet shkalla e vështirësisë, kalohet në procedura të gjata ligjore, por gjithahtu dhe shpenzimet financiare janë shumë herë më të mëdha. Një asistim dhe bashkëpunim shumë të ngushtë dhe kontribut në këtë drejtim na kanë ofruar Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Presim që prindërit e fëmijëve të pa regjistruar, të shfaqnin po kaq bashkëpunim dhe reflektim në këtë proces.

Sipas Z.Bozo nr më i lartë i fëmijëve të paregjistruar pranë zyrës civile jashtë teritorit të Shqipërisë janë fëmijet e lindur në shtetin Grek.

TLAS ka bërë të mundur regjistrimin e këtyre fëmijëve, por shkalla e vështirësisë, dhe kostot kanë qënë të madha. Nëpërmjet marrjes së prokurave nga ana e prindërve të fëmijës kemi vazhduar procedurat për të regjistruar fëmijën. Janë regjistruar 150 fëmijë Rom dhe Egjiptjan që kanë lindur në shtetin Grek.

Një nga vështirësitë që kemi hasur në mënyrë të vazhdueshme, lidhet me dhënien e informacionit të gabuar të të dhënave të prindërve, kur gjyshja ose të afërmit deklarojnë të dhënat pranë zyrës sonë se janë prindërit e fëmijës, por gjatë rrugës zbulojmë se është një e dhënë jo e saktë, shpesh here kjo kategori ngatëron kujdestarinë me të drejtën prindërore. Ka mjaft raste të tilla që na është dashur ti ndjekim me procedura ligjore. Ndaj në rastet që i ndjekim ne gjykatë është perfshirë edhe vërtetësia e fëmijës nëpërmjet ADN-së. Tlas, ka patur dhe ka prioritet për të ofruar shërbime ligjore të plota për pjestarët e komunitetit Rom dhe Egjiptjane sepse janë shtresa me të marginalizuar dhe më të diskriminuar të shoqërisë Shqipëtare. Ky ofrim shërbimi, do të konsistojë edhe në të ardhmen, në ofrimin e shërbimeve ligjore për regjistrimin civil, në mënyrë që edhe kjo kategori të përfitojë të drejtat ligjore dhe sociale.

Pjesa e dytë e workshopit u fokusua në praktikat e ofruara nga ekspertë të fushës së regjistrimit civil. (Ferit Milanj Amaro-Drom)

3.2.3 PRAKTIKA TË MIRA TË PËRMIRËSIMIT TË SITUATËS SË REGJISTRIMIT CIVIL TË KOMUNITETIT ROM NË SHQIPËRI (AMARO-DROM)

Z. Ferit Milanj – ekspert në fushën e regjistrimit civil të fëmijëve Rom dhe Egjiptjan në Shqipëri.

Situata e regjistrimit civil të fëmijëve Rom dhe Egjiptjan mbetet një nga çështjet më të rëndësishme që Amaro-Drom ka patur, dhe vazhdon të ketë në misionin e saj. Ai prezantoi para të ftuarve lidhur me çështjet e mëposhtme:

1. Cfarë duhet nënkuptuar të jesh pa Shtetësi dhe cfarë pasojash shkakton mungesa e kësaj të drejte në mohimin e të gjitha të drejtave të tjera, deri në mohimin e egzistencës së individit të pa regjistruar për arsye nga më të ndryshme.
2. Shkaqet që lidhen me mungesën e regjistrimit civil, duke e lidhur kryesisht me: mungesën e informacionit, mungesën e dokumentacionit përkatës në raste emigrimi, mungesa financiare, etj...
3. Pasojat që lidhen me mosregjistrimin e fëmijëve Rom/ Egjiptjan pranë gjëndjes civile duke renditur dhe analizuar një sërë të drejtash themelore si: e drejta për tu arsimuar, punësuar, për të marrë kujdes shëndetësor, e drejta e pronës etj..
4. Cilat janë dokumentat bazë që nevojiten për të realizuar këtë proces: (Certifikata e asistencës së lindjes, raporti mjekësor hartuar në kohën e lindjes, nëse lindja ndodh në kushte të tjera, lindja vërtetohet dhe nga dëshmitarë, në raste të mungesës së këtyre dokumentacioneve, vërtetimi i lindjes së fëmijës provohet në gjykatë).
5. Çështja e fundit që Z.Mile ndau në këtë workshop, ishte prezantimi para pjesmarësve tre raste të ndryshme, për tu ndarë dhe diskutuar në grupe, dhe për të ofruar zgjidhjet e situatave.

3.2.4 PUNA NË GRUPE DHE PËRFUNDIMET E NXJERA PREJ TYRE

Të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi u ndanë në tre grupe. Secili grup prezantoi se cfarë nismash konkrete duhej të ndërmerreshin në regjistrimin e një fëmije. Rastet ishin të ndryshme, secili grup paraqiti metodikën e punës që duhet të ndiqte për të mundësuar regjistrimin e fëmijës. Grupi i parë paraqiti rastin: "Kur prinderit prisnin lindjen e një fëmije, por ata ende nuk kishin kryer martese ligjore, në gjendjen civile figuronin ende beqare".

Grupi i I-rë

...shpjegoi rrugën se si do të realizohej regjistrimi i fëmijës:

Sipas ligjit 10 129, datë 11.05.2009 për gjendjen civile, gjinia, dhe amësia vërtetohen me anën e certifikatës së lindjes, me raport mjekësor, dhe prania e një dëshmitari në momentin e lindjes së fëmijës. Në kushtet kur dokumentat e nënës janë në rregull, atëherë kryhet regjistrimi në gjendjen civile, kur dokumentat kanë mospërputhje me identitetin e nënës, regjistrimi i fëmijës nuk mund të pranohet. Të dhënat që përcaktojnë një individ janë të përcaktuara nga neni 6 i ligjit Nr. 10 129.

Grupi i II-të

regjistrimi i fëmijës kur një çift kanë bashkëjetuar së bashku, gjatë perjudhës së bashkjetesës sjellin në jetë një fëmijë. Fëmija lind në kushte spitalore. Nëna është e paisur me certifikatën e asistencës së lindjes nga spitali. Për arsye të ndryshme fëmija nuk është regjistruar pranë gjëndjes civile. Nëna braktis fëmijën dhe largohet nga banesa. A ka të drejtë që babai ta regjistrojë fëmijën në këto kushte? Edhe pse babi ka paraqitur certifikatën e asistencës së lindjes. Duke ju referuar rastit, nëna e fëmijës ishte e përfshirë në një bashkëjetesë, sipas kodit të familjes, nenit 181, fillimisht duhet të realizohet vërtetimi i atësisë, dhe pastaj të bëhet e mundur regjistrimi i fëmijës.

Grupi i III-të

prezantoi rastin e një fëmije të lindur jashtë shtetit, dhe nëna nuk kishte asnjë dokument që të vëronte se fëmija ishte e saj.

Si ofrim zgjidhje në këto raste duhet të bashkëpunohet me ambasadën Shqipëtare të atij shteti ku ka lindur fëmija. Sipas ligjit të dytë të nenit 38 të ligjit Nr:10 129, në mungesë të dokumentacioneve që parashtruan në rastin e parë, duhet të fillohet me procedurat ligjore për vërtetësinë e fëmijës nëpërmjet gjykatës duke bërë ADN-në e fëmijës dhe nënës.

Pjesa e fundit e këtij Workshopi ishte diskutimi për të drejtën e arsimit, duke patur parasysh se sapo ka filluar viti i ri akademik. Në këtë çështje përfaqësuesi i ministrisë së arsimit, Z. Besnik Rama falenderoi Amaro-Drom për ftesën dhe për çështjet që kjo organizatë ngreh herë pas here.



Me vjen mirë që sot keni trajtuar edhe të drejtën e arsimit për këtë kategori të shoqërisë, si një e drejtë universale dhe shumë e rëndësishme. Ai u ndal konkretisht në nismën që ministria e arsimit ka ndërmarrë në vite, për paisjen e librave shkollorë të fëmijëve rom dhe egjiptjan, në mënyrë që të ndjekin arsimin e detyruar (9-vjeçar). Ai u ndal gjithashtu edhe në aspektin e legjislacionit, ku në vitin 2006 janë pranuar të frekuentojnë arsimin e detyrueshëm edhe kur fëmijës i mungon certifikata e lindjes.

Në seancën e fundit të workshopit u diskutua edhe për planin e rrjetit në të ardhmen. U ra dakord që në takimin e radhës të rrjetit (i cili do të organizohet brenda muajit Tetor).

3.2.5 REKOMANDIME DHE PERFUNDIME:

- Organizatat Rome dhe egjyptjane të ritin frymën e bashkëpunimit me zyrën TLAS për të reduktuar numrin e fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile.
- Ritja e sensibilizimit të komunitetit rom dhe egjyptjan për ti kushtuar një rëndësi të vecantë regjistrimit të fëmijëve të tyre pranë gjendjes civile.
- Ritjen e sensibilizimit të këtij komuniteti për bashkëpunimin me zyrën TLAS Në ato raste kur hasin vështirësi në regjistrimin e fëmijës, ose dhe në ato raste kur nuk kanë mundësi financiare për të realizuar këtë proces.
- Ritja e sensibilizimit për të kuptuar se cfarë janë në vetvete kujdestaria prindërore, e drejta prindërore, regjistrimi i fëmijes, heqja e të drejtës prindërore, adoptimi i fëmijes etj... Shpesh herë kjo mungesë informacioni sjell shumë bariera dhe vonesa, dhe çështja arrin të ndiqet nga gjykata.
- Arsimimi i këtij komuniteti duhet të rritet. Shtimi i mësuesve ndihmës është një domosdoshmëri që duhet të rritet për të asistuar fëmijët që shfaqin vështirësi në të nxënë
- Politikat që favorizojnë dhe lehtësojnë rrugën drejt arsimimit të këtij komuniteti duhet të jenë në konsideratë

3.3 WORKSHOP KONSULTATIV

“E DREJTA E MINORITETIT ROM PËR TË PËRFITUAR STATUSIN E MINORITETEVE NË SHQIPËRI”

Në 25 nëntor 2016 26 pjesëmarrës (10 Femra) nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, morën pjesë në workshopin me temë **“Forcimi i Dialogut midis Zyrës së Përfaqesuesit Rom në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve dhe Organizatave të shoqërisë civile, mbi statusin ligjor të minoritetit rom në Shqipëri”**.

Workshopi u organizua në Tiranë nga rrjeti kombëtar “Së bashku për forcimin e Zërit Rome/Egjyptian në Shqipëri” udhëhequr nga Unioni Amaro-Drom në kuadër të projektit “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri” financuar nga We Effect.

Pjesëmarrësit në këtë workshop ndanë mendimin se ishte e rëndësishme të realizohej ky proces informimi dhe konsultimi midis Zyrës së Përfaqësuesit Rom në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve (KSHM) me asistencën e një grupi organizatash të shoqërisë civile rom, e rreth projekt-Ligjit për pakicat Kombëtare në Shqipëri dhe efekteteve të tij mbi statusin ligjor të minoritetit rom në vendin tonë. Projekt-Ligji është përgatitur me urdhër të Kryeministrit nga një grup pune ndërinstitutional i cili koordinohet nga Ministria e Jashtme.

Në këtë kuadër, në datën 25 nëntor, 2016 Amaro Drom organizoi takimin e parë konsultativ me rrjetin e shoqërisë civile mbi projekt-Ligjin për pakicat kombëtare. Ky takim celi procesin e parë konsultativ i cili do të vijojë me një seri takimesh në grupe të fokusuara në komunitetet Rome të cilat do të organizohen në javët në vazhdim, sipas një kalendari të përbashkët nga organizatat IRCA, Amaro-Drom, RAA, Ushten, RWRC, dhe LRER,ERRC,etj...

3.3.1 Qëllimi i këtij takimi të parë ishte: nisja e dialogut institucional midis Zyrës së Përfaqësuesit Rom në KSHM dhe organizatave të shoqërisë civile, rreth nëpërmjet informimit, dhe konsultimit rreth përmbytjes dhe efekteve të projekt-Ligjit për Pakicat Kombëtare.

3.3.2 ÇËSHTJET MË TË RËNDËSISHME QË U DISKUTUAN NË KËTË WORKSHOP ISHIN:

Procesi konsultativ mbi projekt-ligjin për Pakicat Kombëtare

1. Kontributi i Zyrës së Përfaqësuesit Rom në KSHM në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile (IRCA, RAA, Ushten, RERC, LRER, etj.) Njohja me përmbytjen e projekt-Ligjit
2. Çështjet kryesore të projekt-Ligjit dhe efekti i tyre mbi minoritetin rom.

Moderimi u realizua nga Z. Skënder Velu, Drejtor Ekzekutiv i Unionit të Romëve të Shqipërisë Amaro-Drom.

Pas prezantimit të rendit të ditës Z. Velu theksoi qëllimin e këtij workshopi dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë aktivitetet, duke e konsideruar këtë takim si një takim historik, sepse është një çështje kombëtare.

3.3.3 KONTRIBUTET NGA SESIONET PLENARE

Gjatë sesionit të parë të workshopit Z. Erion Xhaibra, Anetar i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, shpjegoi për të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim se si kishte filluar procesi konsultativ mbi projekt-Ligjin për pakicat kombëtare, me mbështetjen e konsulentit ligjor Z.Bujar Taho, në bashkëpunim me shoqërinë civile (IRCA, RAA, USHTEN, RWRC, LRER, AMARO-DROM, ERRC, Etj..

Ky Grup Ndërinstitutional i Punës, shpjegoi Z. Xhaibra, është udhëhequr nga Ministria e Jashtme (Urdhri i Kryeministrit nr. 117, datë 10.03.2014) për të identifikuar masat për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe politikat për pakicat.

Aktori kryesor për këtë proces të rëndësishëm historik do të jetë Zyra e Përfaqësuesit Rom në KSHM, sepse bëri të mundur fillimin e procesit informues dhe konsultues me shoqërinë civile, duke vijuar deri poshtë në bazë, në komunitet.

Nëse sot po realizohet takimi i parë konsultativ, për të dialoguar dhe për të njohur me projekt ligjin për pakicat, takimet në vazhdim do të vijojnë me vetë komunitetin për të gjeneruar ide dhe për të marrë sa më shumë këndvështrime në mënyrë që ky projekt- ligj të jetë sa më afër nevojave që ky komunitet ka.

Për të vijuar me juristë dhe me studentë romë, për të reflektuar dhe analizuar me këtë gjeneratë rreth këtij projekt ligji. Ky proces, vijoi Z.Xhaibra, nuk do të përjashtojë askënd por do të jetë një proces tepër transparent dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë të gjitha grupet e interesit. Me pas Z.Xhaibra u ndal tek roli që ka ky komitet (Komiteti Shtetëror i Minoriteteve) në këtë draft- ligj.

Komiteti, Vijoi Z.Xhaibra, është organ konsultativ i qeverisë në lidhje me çështjet dhe problematikat që kanë të bëjnë me të drejtat e minoriteteve në Shqipëri. Komiteti ka të drejtë t'i propozojë organeve Shtetërore të kenë parasysh çështje të rëndësishme të veçantë për minoritetet, veçanërisht përsa i takon zbatimit të detyrimeve kushtetuese, si dhe të akteve të tjera të veçanta që rregullojnë të drejtat dhe liritë e personave që u përkasin këtyre minoriteteve, gjithashtu ka të drejtë t'i propozojë organeve të pushtetit, qendror dhe vendor masat e mundshme dhe konkrete për përmirësimin e nivelit të të drejtave të personave minoritarë.

QËLLIMI I KSHM ËSHTË:

- Të mbështesë, të ruajë, zhvillilojë, dhe promovojë kulturën e pakicave kombëtare
- Mbështetje për përhapjen dhe marrjen e informacionit në gjuhët e pakicave kombëtare
- Mbështetjen në edukimin në gjuhët e minoriteteve kombëtare, dhe edukimin multikulturor
- Mbështetja e projekteve me objekt integrimin e pjesëtarëve të komunitetit
- Propozim i KSHM për arsimin në gjuhët e minoriteteve në ligjin për minoritetet sepse pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre amtare në të gjitha institucionet arsimore parashkollore, arsimi fillor dhe atij të mesëm, etj...

Nëse në pjesën e parë pjesëmarrësit u njohën me rëndësinë që ka ky takim konsultativ, në lidhje me çeljen e dialogut institucional të Zyrës së përfaqësuesit Rom në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile (IRCA, AMARO-DRUM, RAA, USHTEN, RËRC, LRER, ERRC, etj.) dhe roli që ka KSHM në këtë proces.

Pjesa e dytë e këtij workshopi u ndal në njohjen, dhe analizimin rreth draft-ligjit, se çfarë përmban ky draft ligj, dhe çfarë duhet ndryshuar në të.

Ky draft ligj vendos kritere, por nuk specifikon se cilat janë pakicat. Nëse deri tani romët "referohen" si minoritet etno-gjuhësor pavarësisht se Kushtetuta shprehet vetëm për pakica kombëtare. Ky ligj nuk njeh më minoritete gjuhësore, por pakica kombëtare, por ky ligj nuk specifikon se me çfarë do të evidentohemi si pakicë kombëtare

Deklarata e përkatesisë së një personi në një pakicë kombëtare bëhet në regjistrimet periodike (census) të popullsisë së Republikës së Shqipërisë, bazuar në të drejtën e vet-identifikimit.

Pyetje: A është ky instrument i mbledhjes së të dhënave të popullsisë, instrumenti i duhur?

Përgjigje: Censusi bëhet nga INSTAT dhe prodhon statistika, por jo të dhëna personale;

- Gjendja Civile nuk specifikon më kombësinë - Pakicat konsiderohen si pjesë e Kombit Shqiptar;
- Shumica e popullsisë romë, (nga frika e diskriminimit dhe përbuzjes), heziton të vetë-deklarohet si rom gjatë regjistrimit periodik;
- Ligji nuk parashikon burime alternative për identifikimin efektiv të individëve të pakicave
- E drejta e përdorimit të gjuhës romë, dhe përfshirja e saj në shkollat 9 vëcore si një gjuhë me zgjedhje. (kemi njohës të mirë të gjuhës romë, por jo të diplomuar në këtë fushë)

3.3.4 KONTRIBUES PLENARE

Z.Adriatik Hasantari (Roma Aktiv Albania) theksoi se Amaro Drom ka qënë promotori i parë që ka bërë të mundur njohjen e kësaj pakice si minoritet etnik (me Komitetin e Helsinkit në 2002) dhe sot nëpërmjet lobimit të vazhdueshëm, jemi përpara një fakti historik.

Fillimisht të njihemi me këtë draft- ligj, Si ta përmiresojmë këtë dreft ligj, efekti dhe kontributi i të gjithëve për këtë draft ligj.

Ky është një proces ku aleatët kryesorë kanë qënë: Avokati i popullit, Zyra Anti Diskriminim, Shoqeria civile dhe KSHM, do të jenë ata që do ta pasurojnë këtë ligj.

Ngritja e zyrave rajonale për pakicat për tu zhvilluar takimet me grupet e interesit rreth këtij draft ligji, dhe pasurimit të tij, ku Komiteti Shtetëror i Minoriteteve do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim.

Duhet kuptuar, përfundoi Z.Adriatik, se në këtë proces gjithkush do të meret në konsideratë, dhe do të japë kontributin e vet, në mënyrë që të pasurojmë rekomandimet që do të paraqesim pranë ministrisë së jashtme në lidhje me draft ligjin për këtë minoritet.

Kujtim Zelia (Zemra e nënës) përgëzoi këtë nisëm historike, midis të tjerash ai ngriti një pyetje dhe një çështje të rëndësishme për diskutim, se çfarë parashikon ky ligj me emertimin e ri nga minoritet rom, në pakicë kombëtare, çfarë benefitesh do të ketë ky emertim i ri .

Z.Arben Kosturi (Disutni Albania) dha mendimin se duhen marrë për bazë modelet përëndimore për ti përshtatur në vendin tonë.

3.3.5 SI PËRFUNDIM:

- Amaro Drom organizoi takimin e parë konsultativ me rrjetin e shoqërisë civile mbi projekt-Ligjin për pakicat kombëtare. Ky takim ka celur procesin konsultativ i cili do të vijojë me një seri takimesh në grupe të fokusuara në komunitetet Rome, të cilat do të organizohen në javët që vinë sipas një kalendari të përbashkët nga organizatat IRCA, RAA, Ushten, RWRC, LRER, AMARO-DROM etj...
- Ngritja e zyrave rajonale për pakicat për tu zhvilluar takimet me grupet e interesit rreth këtij draft ligji dhe pasurimit të tij, ku Komiteti Shtetëror i Minoriteteve do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim.
- Çështja e emertimit nga "minoritet, në pakicë kombëtare" që njeh ky ligj, apo çështja e gjuhës, do të jenë disa nga çështjet më të rëndësishme që do të trajtohen në takimet e metejshme.
- Ky proces, "draft ligji për minoritetet" nuk do të përjashtojë askënd, por do të jetë një proces tepër transparent, dhe gjithpërfshirës, duke përfshirë të gjithë grupet e interesit.

Në 18 Tetor 2016, 60 pjesmarrës nga të cilat (20 ishin femra), morrën pjesë në eventin ndërkombëtar me temë “Integrimi i Romeve dhe Rritja e Bashkëpunimit midis Shteteve në Rajon”.

3.4 NETWORKU RAJONAL PËR DEKADËN ROME



Qëllimi i këtij takimi kishte si synim jo vetëm paraqitjen e një panorame mbi situatën e romeve në rajon, dhe programeve apo planeve konkrete të ndermarrë nga qeveritë e tyre lidhur mbi masat prioritare të komunitetit rom, por dhe rritjen e bashkëpunimit midis këtyre shteteve për të nxitur qeveritë në lidhje me integrimin e komunitetit rom me pjesën tjetër të shoqërisë.



Eventi ndërkombëtar u organizua në Tiranë nga Amaro-Drom, në kuadër të projektit “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri” financuar nga We Effect.

Ky event mbledhi së bashku pjesëmarrës të ndryshëm të cilët përfaqësonin Zyrën Qëndrore të Amaro-Drom, menaxherja e programit Suedezi, Anna Erlandsson, menaxherin financiar të programit Suedezi Zoran Stefanovski, Avokatin e Popullit, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Integrimit Europian, organizata të shoqërisë civile Rome/Egjyptiane, përfaqësues të Rjetit Kombëtar, të cilat veprojnë në Shqipëri dhe përfaqësues nga organizata Rome të shteteve në Rajon, kryesisht nga: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Kosovë, Mali i Zi, Serbia.

Ky event nuk përjashtoi asnjë organizëm, institucion rajonal, përse i përket kordinimit dhe rritjes së bashkëpunimit për të integruar komunitetin rom në rajon dhe më gjerë.

Përforsimi i angazhimeve midis shoqërisë civile, dhe atyre qeveritare, duhet të jenë në një linjë me politikat konkrete të ndërrmura në kuadër të iniciativave për integrimin e romëve në rajon dhe më gjerë. Qëllimi i këtij takimi kishte si synim jo vetëm paraqitjen e një panorame mbi situatën e romëve në rajon, dhe programeve apo planeve konkrete të ndërrmura nga qeveritë e tyre lidhur mbi masat prioritare të komunitetit rom, por dhe rritjen e bashkëpunimit midis këtyre shteteve për të nxitur qeveritë në lidhje me integrimin e komunitetit rom me pjesën tjetër të shoqërisë.

Zvogëlimin e hendekut socio-ekonomik mes popullsisë romë, dhe jo romë, si dhe forcoimi i përgjegjësisë institucionale të qeverive për të përfshirë objektiva specifike për integrimin e Romëve në politikat kryesore mbetet ende një sfidë jo vetëm për shoqërinë Shqiptare por edhe në Rajon.

Ndaj ky event ndërkombëtar u orjentua në dy drejtime kryesore kryesisht në:

- 1) Politikat social-ekonomike dhe ofrimi i shërbimeve publike
- 2) Planifikimi i buxheteve kombëtare



Rëndësia e këtij eventi lidhet me rritjen e bashkëpunimit Rajonal për të përfshirë dhe konsideruar romët si pjesë të procesit për zgjerimin e bashkimit Europian, si dhe angazhimin e qeverive të vendeve të ndryshme në angazhimin e tyre të plotë në zbatimin e planeve konkrete mbi masat prioritare, dhe planifikime specifike buxhetore.

3.4.1 KONTRIBUTET NGA SEANCAT PLENARE.

Aktiviteti filloi me fjalën përshëndetëse të Z. Skënder Veliu, Drejtor Ekzekutiv i Unionit për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri, Amaro-Drom, i cili gjeti rastin të falenderonte të gjithë bashkëpunëtorët që ndihmuan në realizimin me sukses të këtij eventi ndërkombëtar kaq të rëndësishëm, duke falenderuar në veçanti We-Effect që bëri të mundur realizimin e këtij event.

Midis të tjerash Z.Veliu u ndal në disa çështje të rëndësishme:

- Mbi jetgjatësinë e organizatës Amaro-Drom prej dy dekadash, dhe kontributit të saj në lidhje me integrimin e komunitetit rom në rang kombëtar
- Fokusin kryesor që kjo organizatë ka në lidhje me integrimin e komunitetit rom nëpërmjet arsimit.
- Rolin advokues, dhe lobues që kjo organizatë ndërmer, përsa i përket përfshirjes sociale të këtij komuniteti në përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti
- Paraqitjen e situatës aktuale të komunitetit rom sipas Z.Veliu e lidhi me një sërë problematikash me karakter social, ekonomik, varferinë absolute, nivelin e ulët arsimor, kushte të vështira në infrastrukturë, shëndetësi etj..
- Niveli arsimor i fëmijëve rom është shumë i ulët krahasuar me pjesën tjetër të shoqërisë\Monitorimi i institucioneve që lidhen me ofruesit e shërbimeve mungon.

Fuqëzimi i një zëri të përbashkët rajonal, në lidhje me delegimin e këtyre nevojave drejt qeverive të Shteteve pjesëmarrëse në këtë event ndërkombëtar. Angazhimi ynë i përbashkët, përfundoi Z. Veliu në lidhje me integrimin e romëve, dhe përmirësimin e standarteve të jetesës duhet të përmbushin misionin e dekadës romë me fushat prioritare të saj.

Ky aktivitet u realizua falë projektit të mbështetur nga We-Effect, ndaj Menaxherja e Projektit Anna Erlandsson, në fjalën e saj përshëndetëse midis të tjerash u fokusua kryesisht në Kontributin që We-Effect ofron jo vetëm në Shqipëri por gjithashtu në ballkan.

Më pas fjalën e mori **Z. Igli Totozani**, avokati i popullit, gjatë fjalimit të tij u përqëndrua tek të drejtat e njeriut, kryesisht tek të drejtat dhe zhvillimi social i Minoritetit Rom në Shqipëri.

Ai evidentoi shkeljen e të drejtave të tyre në mënyrë të vazhdueshme edhe të përsëritshme të kësaj pakice etnike, krahasuar me pjesën tjetër të shoqërisë. Sipas tij, problemet më të mëdha të komunitetit janë: strehimi, edukimi dhe integrimi.

Z. Totozani tha se ka nevojë për ndërhyrje urgjente në respektimin e të drejtave të njeriut, duke kërkuar respektimin e parimit të mosdiskriminimit, promovimin e të drejtave të njeriut si dhe masa për një arsimim cilësor të këtij minoriteti duke i integruar në shkollat e tjera publike. Ai theksoi se të gjitha këto arrihen me një frymë të mirë bashkëpunuese të institucioneve shtetërore sepse Shqipëria ka nevojë për për veprime dhe politika të menduara mirë. Zyra e avokatit të popullit, theksoi zoti Totozani, ka më shumë se 5 vite që ka në fokus prioritar çështjen romë, sepse ky institucion ka gjithmonë në fokus grupet më vulnerabël në shoqëri.

Të njohësh nevojat dhe problematikat e një individi apo shoqërie në teresi, vazhdoi Z.Totozani ndodh vetëm kur ti hyn në lekurën e tjetrit, vendos veten në pozicionin e tij, ndaj me bindje të plotë mund të them para jush, se e njoh situatën e vështirë të këtij komuniteti.

Z.Totozani u ndal edhe tek progres-raportin e Komisionit Europian, i cili ka përfshirë si një ndër pikat prioritare për t'u përmbushur, respektimin e të drejtave të Minoritetit Rom, eliminimin e vështirësive që hasin, përjashtimin social si dhe politikat jo efektive, të varfra e antidiskriminuese. Kriteret e vendosura për të qënë pjesë e përfitimeve dhe shërbimeve të ndryshme Socio-ekonomike, janë kritere diskriminuese dhe përjashtuese, Kemi shkolla të segreguara që frekuentohen vetëm nga fëmijë rom.

Ligji për minoritetet është një domosdoshmëri për ti ardhur në ndihmë përmirësimit të kushteve ekstreme të këtij minoriteti, dhe integrimin Europian. Pa mbështetjen në legjislacion nuk mund të ndërmarim inicjativa të tjera që nuk kanë asnjë efektivitet, përfundoi Z.Totozani.

Ministria e integrimit European në Shqipëri **Znj.Gjosha**, ishte një tjetër përfaqësuese në këtë event të rëndësishëm. Sipas saj, integrimi European nuk mund të ndodhë vetëm me një pjesë të shoqërisë, duke përjashtuar në këtë mënyrë integrimin e pakicave. Të parë në kontekstin e integrimit, Znj.Gjosha theksoi rëndësinë që ka respektimi i të drejtave të barabarta, dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

Jemi përballë faktit se kemi një plan strategjik që adreson shumë mirë nevojat dhe fushat prioritare

Ku fëmijet rom kënë disa vite që perfitojnë librat falas, Ku familjet romë që permbushin kriteret janë të perfshira në skemat e ndihmës ekonomike. Por pavarësisht këtyre nismave konkrete, romët perballen me shumë vështirësi dhe probleme serioze socio-ekonomike. Sipas Znj.Gjosha zhvillimi, dhe integrimi i një shoqërie, tregohet në ato raste se sa i respekton dhe i trajton pakicat etnike. Kjo është vëmendja që ne si ministri kemi patur, dhe do të kemi në vazhdimësi.

Zv.Ministre e Ministrisë së Mirqënies dhe Rinisë në Shqipëri, Znj.Bardhylka Kospiri, ishte një tjetër përfaqësuese në këtë event Rajonal.

Me vjen mirë, theksoi Znj. Kospiri që në çdo program progresi në si ministri kemi patur, dhe kemi fokusin tek grupet vulnerabël, sic është dhe ky komunitet. Plani strategjik 2015-2020 ka në fokus objektivat konkrete në integrimin e këtij komuniteti sipas fushave prioritare që duhet ndërhjërë.

Kemi mbështetur familjet e debuara në raste emergjencash.

Presim së shpejti të veprojmë në disa drejtime përkundrejt rritjes së mirqënies në shoqëri, kryesisht në ngritje pagash, ngritje të pensioneve.

Sa i përket arsimit, ajo theksoi se janë ndërmarrë një sërë nismash pozitive për këtë komunitet:

Ofrimin e librave falas, ofrimin e 50 kutova të arsimit të lartë për studentët e këtij komuniteti, ofrimin e programeve nëpërmjet formimit profesional, gjithashtu pritet shumë shpejt një VKM e re në arsim për të mbuluar transportin e fëmijëve për ato familje që nuk e mbulojnë do këtë shërbim, pasi mjedisi i shkollës ndodhet shumë larg zonës së banimit të këtyre fëmijëve.

Duhet kuptuar, vijoi Znj.Kospiri se kjo ministri është në rolin jo vetëm të ofrimit të të gjitha shërbimeve social-ekonomike por në rolin e kordinimit institucional, me qëllim integrimin e kesaj pakice me pjesën tjetër të shoqërisë. Si përfundim ajo theksoi se plani i veprimit 2020 të Romëve dhe Egjyptianëve ka planifikuar planin buxhetor për të përballuar dhe përmbushur të gjitha nevojat e këtij komuniteti.

Eventi ndërkombëtar vijoi me prezantimin e Organizatave Romë të Shteteve të Rajonit, në lidhje me situatën e këtij komuniteti, duke ju referuar programeve dhe politikave sociale që lidhen me fushat prioritare, dhe integrimin e tyre me pjesën tjetër të shoqërisë.

Amaro-Drom, me përfaqësues **Z.Ferit Mile**, ishte prezantimi i parë që bëri celjen e prezantimeve nga Shtetet e Rajonit.

Integrimi i komitetit Rom dhe Egjyptian në zhvillimin socio-ekonomik të vendit mbetet, një nga prioritetet e qeverisë Shqipëtare, pavarësisht angazhimit të qeverisë në këtë aspekt, theksoi Z.Mile, implementimi i ketyre politikave në praktikë qendrojnë shumë larg.

Romët në shqipëri vuajnë nga një sërë fenomenesh sociale: përjashtimi social, diskriminimi, varfëria absolute, etj..

Kjo pakicë, theksoi Z.Mile mbetet një nga grupet më të marginalizuara në shoqërinë në të cilën ne jetojmë. Ai paraqiti një tablo përmbledhëse sa i përket situatës aktuale, dhe problematikave që has komuniteti rom në Shqipëri referuar fushave prioritare sipas dekadës romë:

- **Situata ekonomike** ku të ardhurat për këto familje sigurohen nga puna informale, kryesisht nga riciklimi i mbeturinave, punësimi sezonal, dhe tregtimi i robave të përdorura.
- **Punësimi** dhe shkalla e lartë e papunësisë, ku mbi 50% e të rinjve dhe grave romë janë të papunë, duke shkaktuar pasiguri ekonomike afatgjatë, dhe varfëri ekstreme për këto familje

- **Arsimimi**, Vetëm 13.5% e popullsisë e fëmijëve rom ndjekin arsimin parashkollor. Niveli i braktisjes të shkollës nga fëmijët rom, është shumë i lartë, krahasuar pjesën tjetër të mazhorancës. Aktualisht 54% e fëmijëve rom që janë në moshën 6-16 vjec (për arsim të detyruar) nuk kanë përfunduar asnjë klasë shkollë.
- **Strehimi**: Kushtet e përgjithshme të jetesës së Romëve janë mjaft të ngjashme në të gjitha rajonet ku ata jetojnë. Shumë zona të banuara nga Romët janë informale dhe nuk kanë kushtet thelbësore të tilla si sistemet e kanalizimeve, shërbimin e largimit të mbeturinave, furnizimin me ujë, rrugë, si dhe banesat e tyre janë të një karakteri të përkohshëm, të pasigurta dhe të paqëndrueshme në raport me motin. Pronësia mbi tokën është një nga problemet që ka krijuar mjaft vështirësi në zbatimin e pjesës së strategjisë së strehimit, sepse zonat e banuara nga Romët nuk janë pjesë e zonave informale të cilat rregullohen me rreformat e legalizimit.
- **Situata shëndetësore e Romëve** është në përgjithësi e keqe, për shkak të një mjedisi familjar që paraqet rezik të lartë dhe kërcënim për shëndetin dhe mirqënien e këtyre familjeve, ambjenteve jo të përshtatshme shëndetësore, mungesë aksesit në shërbimet shëndetësore bazë, keqshqyerje, etj..

Prezantimi i dytë u realizua nga Bosnjë dhe Hercegovina, nga perfaqësuesit e organizaes Rome Kali Sara "Roma Information Center" prezantuar nga Z. Dervo Sejdić. Sipas tij ashtu si në shumë vende të tjera të rajonit edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjendja e minoritetit rom nuk është shumë e mirë. B/H ka miratuar ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare, e cila i dha të njëjtën të drejtë për të gjithë shtetasit e saj, nga pakicat e ndryshme. Ka dhe disa plane të ndryshme që janë mbështetur nga Këshilli i Ministrave, plane të tilla si: Plani i Veprimit për vitin 2004 për arsimimin e minoritetit rom, në vitin 2004 kanë miratuar Strategjinë, në vitin 2008 Plani i Veprimit për Strehimit, punësim dhe shëndetësi, dhe në 2005-2015 ata u bënë pjesë e Dekadës. Roma është pakica më e madhe në B/H dhe është ai që është më në nevojë se të tjerët, në këtë drejtim shumë grante janë dhënë për të përmirësuar gjendjen e romëve, por shumica e granteve po bëhet gjithnjë e më e ulët. Arsimimi, përveç strehimit dhe shëndetit është një sektor tjetër i cili ka nevojë për një shumë vëmendje për shkak se fëmijët e komunitetit rom kanë më të ulët të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor apo nivelet e tjera të arsimit. KIC është përpjekur për të përmirësuar situatën e këtij minoriteti në B/H, dhe ka realizuar shumë projekte që nga krijimi i saj në vitin 2009, duke përmirësuar gjendjen e strehimit, shëndetësisë dhe arsimit. KIC ka për objektiva të saj për të rritur politiken, ekonominë, arsimin, dhe kulturorën e komunitetit rom në B/H, përmes avokimit, efikasitetit në zbatimin e planeve të ndryshme, dhe promovimin e kulturës dhe historisë së tyre.

Pas prezantimit të Bosnje Hercegovinës, ishin partnerët tanë të We effect nga Kosova, që vijuan me prezantimin e tyre "Initiative for Kosova Community – IKC" Prezantuar nga Z.Agron Arifi.

Fillimisht Z.Arifi prezantoi qëllimin që kjo organizatë kishte në vetvete:

"Në Krijimin e një shoqërie të zhvilluar rurale dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë përmes përforsimit të kapaciteteve të shoqërisë civile, komuniteteve lokale dhe qëndrore. Ndër problematikat që komuniteti rom has në Kosovë sipas IKC ishin:

- mungesa e kualifikimeve,
- mungesa e informacionit mbi mundësitë për punësim,
- problemet gjuhësore,
- mungesa e investimeve në zhvillimin e bizneseve të vogla dhe sektorin e bujqësisë,
- qasja e kufizuar në institucionet publike dhe ndërmarrjet private,

Burimet e të ardhurave të tyre sigurohen nëpërmjet: mbledhjes dhe riciklimin e mbeturinave, asistencë sociale rreth €85 në muaj. Tradicionalisht, ky komunitet ballafaqohet me analfabetizëm të lartë. Një problem tjetër është edhe strehimi i këtij komuniteti. Ambientet në të cilat ky komunitet jeton nuk janë aspak të shëndetshme sepse mungon sistemi i ujërave të zeza, si dhe mungesa e higjienës.

Z.Arifi paraqiti disa ndërhyrje konkrete në ndihmë të këtij komuniteti. IKC në punën e saj ka qënë e kujdesshme në përfshirjen e këtij komuniteti në të gjitha aktivitetet në mënyrë të veçantë integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare, dhe fuqizimin e tyre shoqëror dhe ekonomik.

Duke formuar grupe formale dhe jo-formale të këtij komuniteti, po ashtu kemi formuar grupe të përbëra nga komuniteti rom dhe shqiptarë.

Meqënëse gratë konsiderohen si grupi më i marginalizuar, ne ju kemi dhënë një mundësi që të aftësohen dhe të zhvillojnë biznese familjare.

Prezantimin 'IKC' e mbylli me disa histori suksesi që kjo organizatë ka mbështetur në kuadër të projektit të financuar nga We- Effect.

Aktiviteti vjoi me një tjetër prezantim, nga Mali i zi, "NGO Young Roma" prezantuar nga Mr. Samir Jaha, Duke njohur dhe informuar të pranishmit me kontributin 11 vjecare të kësaj organizate.

Problematikat dhe nevojat e komunitetit rom ishin pothuajse me të njëjtat dimensionet, dhe me të njëjtat veshtirësi dhe problematika sociale. Kemi bërë të mundur strehimin e 48 familje romë (Në potgoricë)

15% e komunitetit rom jeton në Potgoricë. Sipas Z. Samir, mungojnë fonde të mjaftueshme për të ardhur në zbatim për të përmirësuar kushtet e komunitetit rom. Edhe në Malin e Zi kemi një numër të lartë të të papunëve rom. Duke dëgjuar me vëmendje shtetet e tjera pjesëmarrëse, romët në Malin e Zi paraqesin numër më të ulët të romëve që kanë kryer arsimin e detyrueshëm.

Z. Jaha u ndal gjerësisht në kontributet që kjo organizatë ka ofruar në kuadër të disa projekteve në përmirësimin e kushteve të komunitetit rom, kryesisht në rritjen e punësimit dhe përfshirjes së gjeneratës së re romë në tregun formal të punësimit

Znj. Katerina Shojik përfaqësuese e organizatës Rome "National Roma Centrum" nga Maqedonia, ishte një tjetër prezantim i radhës. Sipas Saj, ashtu si në shumë vende në Ballkan, edhe në Maqedoni Komuniteti rom është duke u përballur dhe vuan pothuajse nga të njëjtat probleme të tilla si: diskriminimi, mungesë të kujdesit shëndetësor, niveli i ulët i pjesëmarrjes në arsim parashkollorë, mungesën e legalizimit të shtëpive të tyre për shkak të mungesës së informacionit, si dhe për shkak të problemeve financiare, papunësia, mungesa e dokumentacionit etj por çfarë duket të jenë të ndryshme në Maqedoni është arritja e NRC-së. Nga kjo organizatë Komuniteti rom ka përfutur miratimin e projekteve dhe iniciativave për të trajtuar më mirë problemet e ndryshme dhe kanë arritur të përmirësojnë disa aspekte të problemeve të tyre si: legalizimin e shtëpive të tyre, qasje ligjore falas, 9 projektet e arsimit, qasjes në drejtësi etj

3.4.2 KUFIZIMET E KËTIJ AKTIVITETI

- Qëllimi i këtij aktiviteti ishte pikërisht Integrimi i romëve dhe rritja e bashkëpunimit të shtetve të Rajonit për të nxitur qeveritë e vendeve të ndryshme në angazhimin e tyre të plotë në zbatimin e planeve konkrete mbi masat prioritare, dhe planifikime specifike buxhetore.
- Kjo pa dyshim është një iniciativë shumë e mirë, por kërkon bashkëpunim Rajonal në vazhdimësi, derisa të përmbushet ky objektivi.
- Situata e komunitetit rom në Ballkan has të njëjtat sfida, dhe paraqet të njëjtat problematika socio-ekonomike, duke e konsideruar si grupin më vulnerabël në shoqëri.
- Qeveritë e shteteve përkatese pavarësisht programeve apo planeve të veprimit të cilat adresojnë shumë mirë fushat prioritare që tashmë janë lehtësisht të evidentueshme, nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar jetesën e kësaj pakice me pjesën tjetër të shoqërisë.
- Pavarësisht se janë vendosur shumë fonde nga Bashkimi Europian për të integruar këtë komunitet, mënyra për të përthithur këto fonde kërkon fuqëzimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të aplikuar në këto fonde.
- Rritja e bashkëpunimit midis shteteve të rajonit e bën edhe më të lehtë rrugën për të bërë të mundur përthithjen e këtyre fondeve, në ato raste kur kapacitetet nuk mungojnë.